Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Zyra e Drejtorit/ Kancelarija Direktora /Office of the Director

Numër: 178/02
Datë: 10.06.2014

Drejtori i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK), mbështetur në nenin 142, me të gjitha pikat të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 5, 10, 11, 14 dhe 15 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikime Kombëtare, nenin 50 të Ligjit nr. 03/L- 189 për administratën shtetërore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare, nr. 82, 21 tetor 2010), nenit 26 dhe shtojcës 6 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive dt. 22.03.2011, nxjerrë :

VENDIM

1. Shfuqizohet vendimi i drejtorit të AKK-së nr. 38/12 i datës (05.07.2012) për angazhimin e përkthyeseve për përkthim të dokumenteve të nevojshme dhe përkthim gjatë seminareve/punëtorive.

2. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Duke u mbështetur në dispozitat e shënuara më lartë si dhe duke marrë parasysh që MASHT ka kontraktuar një kompani për përkthime që mund të shfrytëzohet edhe nga AKK për përkthime të dokumenteve dhe gjatë seminareve dhe punëtorive, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:
1. Zyrës për buxhet dhe financa
2. Zyrës së Drejtorit të AKK
3. Stafit të AKK-së
4. Arkivit

Teuta Danuza,
Drejtor i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve